



Të Drejtat e Romëve dhe të Komuniteteve Shtegtarenë Europë

Pjesë të shkëputura nga raporti i plotë



COMMISSIONER FOR HUMAN RIGHTS
COMMISSAIRE AUX DROITS DE L'HOMME



Të Drejtat e Romëve dhe të Komuniteteve Shtegtarenë Europë

(Pjesë të shkëputura nga raporti i plotë)

Opinionet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflektojnë detyrimisht politikën zyrtare të Këshillit të Europës.

Çdo kërkesë për shtyp i përket riprodhimit ose përkthimit të të gjithë ose të një pjese të këtij dokumenti, duhet t'i dërgohet Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int). Çdo korrrespondencë tjetër mbi këtë publikim duhet t'i dërgohet Zyrës së Komisionierit mbi të Drejtat e Njeriut.

Raporti i plotë (në anglisht) mund të porositet në: <http://book.coe.int>

Ai mund të gjëndet gjithashtu në faqen e internetit: www.commissioner.coe.int

Kopertina dhe formati: Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe Publikimeve të Këshillit të Europës

Foto: Aktivistët e të drejtave të romëve mbulojnë fytyrat e tyre me kopje të zmadhuara të gjurmëve të gishtave gjatë një proteste përballë Ambasadës Franceze në Bukuresht, Rumani. Ata protestojnë kundër vendimit të autoriteteve franceze për të përzënë romët me preardhje rumune dhe bullgare drejt vendeve të tyre të origjinës.

© AP Foto/Vadim Ghirda

© 2011 Council of Europe/Akil Kraja, on Albanian translation

© 2011 Council of Europe, on publication in English

Parathënie

Vetëm pak mijëra romë në Gjermani arritën t'u mbijetonin Holokaustit dhe kampeve të përqëndrimit nazist. Ata u përballen me vështirësi të panumërta gjatë përpjekjes së tyre për të rifilluar jetën nga e para, pasi kishin humbur shumë familjarë dhe të afërm, sikurse dhe pronat e tyre të cilat ishin shkatërruar ose konfiskuar. Shendetit i shumë prej tyre ishte përkeqësuar. Për vite me rradhë, kur disa tentonin të kërkonin rikompensim, kërkesat e tyre refuzoheshin.

Për të mbijetuarit, drejtësia nuk erdhi dhe pas periudhës post-Hitleriane. Në mënyrë domethënëse, vrasjet masive të romëve nuk ishin pjesë e gjyqimit të Nurenbergut. Genocidi ndaj romëve pranohej vetëm përciptas në fjalimet publike.

Nuk u njohën po ashtu dhe krimet që regjimet fashiste bënë ndaj romëve në të njëjtën periudhë në vende të tjera në Europë. Në Itali, një qarkore e 1926-ës, urdhëronte dëbimin e të gjithë romëve të huaj në mënyrë që “të pastrohej vendi nga karvanet e ciganëve të cilët, e panevojshme të rikujtohet, përbëjnë një rrezik për sigurinë dhe shendetin publik nga kultura e jetesës cigane”.

Urdhri e bënte të qartë se qëllimi ishte të “godiste në zemrën e organizimit cigan”. Ajo ç'ka vijoi në Italinë fashiste ishte diskriminimi dhe persekutimi i tyre. Shumë romë u burgosën në kampe speciale; të tjerë u dërguan në Gjermani ose Austri dhe më pas u shfarosën.

Regjimi fashist rumun, “Garda e Hekurt”, filloi deportimet në 1942. Ashtu si shumë hebrenj, përafërsisht 30.000 romë u sollën në krahun tjetër të lumit Dniester ku vuajtën nga uria, sëmundjet dhe vdekja. Vetëm gjysma e tyre i mbijetuan dy viteve të punës ekstreme para se politika të ndryshonte.

Historia e persekutimit ndaj romëve e paraprin periudhën naziste dhe fashiste. Në fakt, ajo daton disa qindra vite me parë – menjëherë pas migrimit të romëve nga subkontinenti indian. Romët ishin të huajt që shërbenin si koka turku kur situatat shkonin keq dhe njerëzit vendas nuk dëshironin të merrnin përsipër përgjegjësinë. Metodatat e persekutimit kanë ndryshuar me kohën duke përfshirë skllavërimin, asimilim e sforcuar, përzënie, internimin dhe vrasjet masive.

Komisionet e të vërtetës duhet të vendosen në një numër shtetesh europiane për të vendosur të vërtetën mbi mizoritë masive kundra popullatës rome. Idealisht, kjo duhet të jetë një nismë mbarë europiane. Një vlerësim dhe pranim i plotë i këtyre krimeve mund të ndihmojë në rivendosjen e besimit mes romëve e shoqërisë në tërësi.

Jo çuditërisht, shumë romë vazhdojnë t'i shohin autoritetet si një rrezik. Kur u kërkohet të rregjistrohen ose të japin gjurmët e gishterinjëve, ata mendojnë më të keqen. Kjo është më se e kuptueshme kur ata shpjegojnë se si ata shohin ngjashmeri mes retorikës së sotme kundra romëve dhe gjuhës të përdorur në të shkuarën në Europë, nga nazistët, fashistët dhe ekstremistët e tjerë.

Romët janë paragjykuar kolektivisht si kriminelë dhe në deklarata gjithëpërfshirëse befasuese të kohëve të fundit. Një shembull është Franca ku qeveria gjatë periudhës korrik-gusht 2010 vendosi të dëbojë emigrantët romë të ardhur nga vende të tjera të BE-së, duke përdorur dhe forcën nëse ishte e nevojshme. Fushata e qeverisë u shoqërua nga një retorikë flagrante anti-rome. Komuniteti rom u lidh në tërësi me kriminalitetin. Prezenca e tyre u përshkrua si një rrezik ndaj “sigurisë

publike” –një përcaktim legal, i cili përdoret normalisht për situata të jashtëzakonshme ku paqja dhe mbijetesa e shtetit konsiderohen në rrezik.

Lidhja e supozuar mes romëve dhe kriminalitetit është një refren i përsëritur në gjuhën e urrejtjes. Kjo mund të kundërshtohet dhe keqkuptimet mund të sqarohen – nëse mendjet janë të hapura për një shkëmbim racional. Sigurisht, disa romë janë fajtorë për kryerjen e krimeve. Disa edhe janë përdorur dhe instrumentalizuar nga trafikantët. Por njerëzit e lënë mënjanë nga shoqëria ashtu si dhe të varfërit janë të mbipërfaqësuar në statistikat e kriminalitetit në shumicën e vendeve, për arsye më se të qarta. Është gjithashtu e vërtetë që ata mund të jenë më të pafavorizuar në sistemin e drejtësisë, çka në vazhdimësi ndikon në statistika.

Këto probleme nuk mbartin asnjë justifikim për të stigmatizuar të gjithë romët, shumica e të cilëve nuk janë në konflikt me ligjin. Është një princip etik kritik, që një grup i tërë nuk duhet të dënohet për atë çka një anëtar i tij mund të ketë bërë më parë.

Pasojat e deklaratave ksenofobe nga politikanë të rangut të lartë nuk duhen nënvleftësuar. Disa mendje me qëllime të këqija mund t’i kuptojnë këto deklarata si autorizime për të ndëshkuar por dhe për sulme fizike. Retorika e pavend e disa kandidatëve gjatë zgjedhjeve italiane të 2008 u ndoq nga incidente dhune të shëmtuara kundrejt individëve dhe kampeve rome. Vrasjet në gjakftohtësi të gjashtë romëve, duke përfshirë një fëmijë 5 vjeçar, në Hungari në 2008-09, u bënë në një atmosferë të mbushur nga gjuha e urrejtjes.

Fryma anti-cigane është duke u përdorur përsëri sot nga grupet ekstremiste në disa shtete europiane. Turma që ushtrojnë dhunë kundër individëve romë, janë raportuar, për shembull, në Republikën Çeke dhe në Hungari.

Përfaqësuesit e shtetit me të cilët romët kanë tendencë të jenë më shpesh në kontakt janë policët. Gjatë misionëve të mia, jam befasuar në shumë vende nga shenjat e marrdhënieve të këqija mes komuniteteve rome dhe policisë. Shumë romë kanë dhënë shembuj specifikë sesi policia ka dështuar në mbrojtjen e tyre nga sulmet e bëra nga ekstremistët. Akoma më të rënda janë rastet kur vetë oficerët e policisë kanë qenë shkak i dhunës.

Fryma anti-cigane vazhdon të jetë e përhapur në Europë. Në kohën e problemeve ekonomike, duket se tendenca kundra kokave të turkut si pasojë e zhgënjimit rritet – dhe romët duket të jenë një nga shënjestrat më të thjeshta. Në vend që të peshkojnë në ujëra të turbullt, politikanët kombëtarë dhe vendorë duhet të ngrihen dhe të flasin në mbështetje të parimeve të jo-diskriminimit dhe në respekt të njerëzve me origjinë të ndryshme. Më e pakta që vetë politikanët duhet të bëjnë është të evitojnë në rradhë të parë retorikat anti-rome.

Në këtë drejtim mund të ndërmerren një seri hapash konkretë. Keqtrajtimet e shkuara ndaj romëve duhet të përfshihen në mësimet e historisë në shkolla. Profesione të kyçe si policia, duhet të trajtohen mbi nevojat për të mbrojtur romët nga krimet e frymëzuara nga urrejtja, dhe të merren masa disiplinore nëse policët vetë sillen në mënyra jo të përshtatshme.

Më e rëndësishme është nevoja që politikanët e zgjedhur të tregojnë lidhshmëri morale: ata duhet të inkurajojnë, dhe të praktikojnë në jetën e përditshme, një angazhim ndaj respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut për gjithsecilin.

Unë shpresoj që kjo përmbledhje e politikave ndaj romëve në Europë sot do të inkurajojë një diskutim konstruktiv mbi atë çka mund të bëhet në mënyrë që t’i jepet fund diskriminimit dhe marginalizimit.

Thomas Hammarberg

Përmbledhje

Romët, dhe komunitetet shtegtare, përbëjnë së bashku grupin minoritar më të madh në Europë. Komisioneri ka observuar gjatë vizitave së tij në vëndet anëtare të Këshillit të Europës, se diskriminimi dhe abuzimet e tjera me të drejtat e njeriut kundër romëve dhe njerëzve të udhëtimit janë rënduar dhe se asnjë qeveri europiane nuk mund të pretendojë për një rezultat plotësisht të suksesshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të këtyre minoriteteve. Kjo pikëpamje nxiti realizimin e një raporti gjithëpërfshirës mbi situatën e romëve dhe shtegtarëve në Europë.

Fryma anti-cigane

Raporti tregon se fryma anti-cigane është thellësisht e rrënjosur në Europë. Shumë njerëz të cilët nuk kanë ndërvepruar kurrë me romë apo individë shtegtarë, janë të gatshëm të japin përshkrime të detajuara dhe të ngarkuara me stereotipe mbi paraqitjen dhe sjelljen e romëve dhe të shtegtarëve. Figura publike dhe aktorë të opinionit – qofshin zyrtarë të zgjedhur apo të tjerë – kanë shpifur hapur kundra romëve dhe shtegtarëve duke përdorur retorikë raciste ose stigmatizuese. Në disa raste, këto fjalë janë kuptuar si inkurajuese të dhunës kundra romëve si në rastet e akteve apo aksioneve të dhunëshme nga turmat. Komisioneri është i mendimit se ligjërata anti-rome, duke përfshirë dhe periudhat elektorale, duhet të ndëshkohet fuqishëm në të gjitha rastet dhe të dënohet ligjërisht, kur ajo thyen ligjin kundër frymëzimit të urrejtjes. Partitë politike duhet gjithashtu të adoptojnë masa vetë-rregullatore që përjashtojnë gjuhën raciste.

Në një numër gjithmonë më të madh vendesh europiane, grupet ekstremiste vënë në shënjestër romët dhe shtegtarët, duke nxitur në disa raste pjesë të publikut kundër këtyre individëve. Këto grupe ekstremiste janë tejet aktivë në internet, një mjet i cili ka lejuar një bashkëpunim ndër-kufitar më të fortë mes grupeve të ngjashëm me pikëpamje ekstremiste. Këto grupe janë aktive në rekrutimin e të rinjve duke përdorur teknika të ndryshme, përfshi organizimin e koncerteve të muzikës me frymë urrejtjeje. Grupet e sigurisë dhe paramilitarëve veshin shpesh uniforma, përdorin armë dhe po shtrëngojnë gjithmonë e më shumë rrjetën e tyre ndaj romëve duke lëshuar kërcënime verbale dhe fizike, si dhe duke organizuar protesta masive. Është zbuluar se anëtarët e këtyre grupeve ekstremiste janë burimi i një numri krimesh urrejtjeje kundër romëve. Komisioneri ka rekomanduar ndalimin e financimit për organizatat që promovojnë racizmin, duke përfshirë dhe partitë politike. Për shtetet, mund të konsiderohet e dobishme dhe shkrirja e partive ekstremiste, kur ato gjykohen si të papajtueshme me standartet dhe vlerat e një shoqërie demokratike.

Stereotipet anti-cigane vazhdojnë të përhapen dhe të ripërsëriten dhe nga media anembanë Europës. Disa gazeta dhe media transmetuese kanë raportuar mbi romët dhe shtegtarët vetëm në kontekstin e problemeve sociale dhe krimet. Komisioneri ka theksuar nevojën për një vetërregullim dhe një gazetari etike për ti dhënë fund përshkrimit negativ të romëve në media. Si një parim i përgjithshëm, çfarë është e paligjshme jashtë lidhjes në internet, duhet të jetë e paligjshme dhe gjatë lidhjes në një kontekst ku interneti përdoret për të përhapur fjalë urrejtjeje anti-rome dhe nxitur dhunën. Shtetet anëtare duhet të krijojnë mekanizmat që monitorojnë racizmin në internet, në përputhje me Rekomandimet e Politikës së Përgjithshme Nr.6 të Komisionit European kundër

Racizmit dhe Intolerances (ECRI) mbi luftën ndaj përhapjes së materialeve raciste, ksenofobe dhe antisemite në internet.

Fryma anti-cigane mund të përmbajë gjithashtu refuzimin e njohjes së historisë rome të vuajtjeve të mëparshme, në veçanti gjatë Luftës së Dytë botërore. Ky mohim pasiv manifestohet shpeshherë në heshtjen mbi viktimat rome në ceremonitë dhe monumentet përkujtimorë, në mbulimin që i bëhet nga media, në librat zyrtare ose në tekstet e historisë. Komisioneri thekson se asgjësimi i romëve gjatë Luftës së Dytë botërore nuk duhet të harrohet. Mësimdhënia e historisë rome, ngritja e vetëdijes mbi genocidin rom gjatë Luftës së Dytë botërore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e monumenteve përkujtimorë janë më e pakta që shtetet anëtare mund të bëjnë për të nderuar viktimat rome. Qeveritë anembanë Europës duhet të përkthejnë në gjuhën e tyre fishat ekzistuese të Këshillit të Europës mbi historinë rome në mënyrë që t'i përdorin dhe t'i shpërndajnë sa më gjërë të jetë e mundur sipas konteksteve kombëtare, duke përfshirë dhe shkollat. Duhet të krijohen gjithashtu komisionet e të vërtetës – në mënyrë ideale si një nismë ndër-europiane – që të vendosen faktet historike mbi keqtrajtimet e realizuara ndaj komunitetit rom.

Dhuna me karakter racist kundra romëve dhe komuniteteve shtegtare

Dhuna kundër romëve dhe komuniteteve shtegtare ka qënë e përhapur në Europën e pas 1989-ës, dhe është ndjekur nga një rritje e ndjeshme e rasteve serioze në vitet e fundit. Në disa kontekste, kjo dhunë është përhapur nga organizata fashiste ose grupe neo-naziste duke përfshirë planifikimin dhe përgatitjen e saj. Gjithsesi, dhuna anti-rome nuk kryhet vetëm nga grupet e organizuara. Në disa raste, komunitete jo-rome janë përfshirë në një mënyrë pak a shumë spontane në aksione dhune me qëllim mbrojtjen parandaluese nga romët dhe shtegtarët; ndërsa në disa raste të tjera dhuna është kryer nga individë të motivuar thjesht nga urrejtja raciste pa u identifikuar me një ideologji politike të veçantë. Në disa shtete, dhuna anti-rome është rezultat i një kombinimi të disa prej këtyre formave.

Zhvillimi gjatë viteve të fundit të lëvizjeve të nxitura nga ideologji të bazuara tërësisht apo pjesërisht në urrejtjen kundër romëve përbën një çështje tejet shqetësuese. Këto lëvizje kanë realizuar sulme të dhunshme dhe shumë raste me pasoja vdekje-prurëse. Më konkretisht, sulme gjatë natës me zjarrvënie të qëllimshme janë bërë në disa raste ndërsa njerëzit flinin. Në situata të tjera, zyrtarët publikë janë përfshirë direkt në nxitjen e aksioneve të sigurisë kundra romëve dhe komuniteteve shtegtare. Komisioneri e gjykon të nevojshëm dyfishimin e përpjekjeve në këtë fushë, në të gjitha nivelet, në mënyrë që të jepet një mesazh i qartë ndaj autorëve të mundshëm duke inkurajuar njëkohësisht viktimat të raportojnë incidentet keqdashëse. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që policia heton në tërësi sulmet raciste, duke konsideruar plotësisht racizmin si një motiv i akteve kriminale, dhe të vendosin mekanizma të monitorimit sistematik të akteve raciste.

Trajtimi i romëve dhe komuniteteve shtegtare nga autoritetet ligj-zbatuese dhe gjyqësore

Raportet e marra nga Komisioneri nga anembanë Europës dëshmojnë modele diskriminimi dhe keqtrajtimi të romëve dhe komuniteteve shtegtare nga policia. Romët kanë qënë objekt i dhunës policore qoftë në ambjentet e ndalimit ashtu dhe në hapësirat publike, për shëmbull gjatë aksioneve policore në kampet e romëve. Dhe në ato raste kur këto veprime janë ndjekur nga një hetim penal, ato duket se kanë qënë qartësisht të njëanëshme ose diskriminuese. Komisioneri ka observuar se jurisprudenca e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata e Strazburgut) tregon qartazi se në këto situata shtetet anëtare janë të detyruar të kryejnë një hetim real të motiveve të mundshme me karakter racist. Komisioneri fton shtetet anëtare të vendosin mekanizma të

pavarur ankesash në mënyre që të përmirësohet besimi i romëve dhe komuniteteve shtegtare ndaj autoriteteve që zbatojnë ligjin.

Ekzistojnë një seri raportesh që tregojnë se disa vendbanime të izoluara romësh kanë qenë objekt i një kontrolli të veçantë nga ana e policisë, shpesh duke marrë formën e aksioneve të pavend. Policia ka realizuar në një mënyrë diskriminuese verifikime të tipit “ndal-kontroll” ndaj romëve në makina ose në automjete të tjera. Është hasur gjithashtu ruajtja e profileve me karakter etnik në kontekstin e transportit të romëve në kufijtë ndërkombëtarë. Komisioneri ka nënvizuar se romët nuk duhet të jenë objekt i asnjë praktike policore, që do të ndryshonte nga ajo me të cilën do të përballej normalisht popullata e përgjithshme. Ligjet duhet të ndalojnë në mënyrë të qartë profilin etnik dhe të vendosin standarte dyshimi të arsyeshëm mbi operacionet policore. Policia duhet të marrë trajnime për këto çështje, sipas rekomandimeve të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës në Rekomandimet e Politikës së Përgjithshme Nr.11 mbi luftën ndaj racizmit dhe diskriminimit racial në aksionet e policisë.

Përfaqësuesit e popullsisë rome, kanë raportuar gjithashtu raste sekuestrimi arbitrar të pronës ose të zhvatjes nga ana e policisë. Këto praktika shkelin Artikullin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (i cili mbron të drejtën për jetën private dhe familjare) dhe prekin mbrojtjen e romëve nga të tjera të drejta të njeriut, duke përfshirë të drejtën për strehim dhe siguri.

Për më tepër, romët janë disproporcionalisht objekt i masave arbitrare të paraburgimit. Komisioneri beson se përdorimi i tepruar i forcës policore në këtë fushë duhet të marrë fund, dhe se masa konkrete duhet të ndërmerren që të sigurohet se romët nuk janë më objekt i paraburgimeve arbitrare. Hapa të tjerë duhet të ndërmerren për të rivendosur besimin me komunitetin rom dhe atë shtegtar, si për shëmbull punësimi i romëve në polici ose punësimi dhe trajnimi i ndërmjetësve romë që të kenë mundësi të mbajnë lidhje me policinë.

Në një numër shtetesh, romët duket se diskriminohen në vendimet për paraburgimin, në nivelin të ndjekjeve penale dhe vendimeve të gjykatave. Disa nga problemet e hasura nga romët në fushën e drejtësisë penale kanë të bëjnë me mungesën e një përfaqësie të përshtatshme gjatë ballafaqimit me akuzat, mungesën e respektit ndaj romëve si dëshmitarë ose mangësi gjatë përkthimit. Parimi i prezumimit të pafajësisë nuk është i respektuar gjithmonë kur individët romë dalin në gjyq. Është e rëndësishme që të ndërmerren hapa që parandalojnë diskriminimin racor kundra personave të akuzuar me origjinë rome, të cilët janë nën hetim gjyqësor në mënyrë që këta persona të marrin një gjykim të drejtë.

Këto probleme bëhen më të komplikuar nga dështimi i sistemit të drejtësisë për t’u përgjigjur në mënyrë të përshtatshme ndaj ankesave të bëra nga romët për diskriminim racor dhe/ose abuzime të tjera. Përpjekjet që synojnë përmirësimin e efikasitetit të përgjigjes që i jep sistemi i drejtësisë diskriminimeve duhet të përmbajnë vendosjen e një legjislacioni anti-diskriminim efikas ose përforcimin e tij, si dhe të organeve të specializuara të cilat do të ofronin një mekanizëm të thjeshtëzuar për të ndjekur ankesat dhe për të ndihmuar në zbatimin e ligjit.

Respekti për një jetë private dhe familjare për romët dhe shtegtarët

Sterilizimi me forcë dhe detyruet i grave rome

Nga fillimi i viteve 1970, nën influencën e ringjalljes së arsytetimeve eugenike në fazën e fundit të komunizmit, sterilizimi u promovojë, disproporcionalisht anëtarëve të minoritetit rom nga punonjësit socialë si një metode e planifikimit familjar në kuadrin e politikave kombëtare dhe rajonale. Pas rënies së komunizmit, qeveritë e reja u përpoqën t’u jepnin fund praktikave të tilla. Por, disa specialistë të shëndetit duket se kanë vazhduar këtë praktike shumë gjatë pas tranzicionit në Republikën Çeke dhe Sllovake, duke sterilizuar gratë rome pa dakortësinë e plotë

dhe të informuar të tyre pasi ato ishin paraqitur pranë tyre për procedura të tjera obstetrike/gjinekologjike. Raste të tillë janë ndeshur dhe në Hungari.

Në nëntor të 2009, avokati i popullit çek Otakaj Motejl, raporti i të cilit në vitin 2005 mbi këtë temë është një ndër studimet më të rëndësishme mbi trashëgiminë e sterilizimit të detyruar në Çekosllovakia dhe në shtetet që e ndoqën, thotë se mbi 90.000 gra mund të jenë sterilizuar në territorin e ish-Çekosllovakisë që nga fillimi i viteve 1980. Si një nga vendet që vazhdoi këtë praktikë, pas viteve 1990 vetëm Republika Çeke ka shprehur zyrtarisht një formë keqardhjeje “mbi disa raste gabimi” në nëntor të 2009-ës. Në asnjë nga këto vende nuk duket se ekziston një sistem kombëtar kompensimi i cili t’i adresohet shumicës së këtyre viktimave për riparimin dhe rimbursimin e ketyre praktikave. Komisioneri beson se të gjithë shtetet e prekura duhet të njohin publikisht se këto praktika kanë ekzistuar, të shprehin keqardhjen dhe të krijojnë mekanizma riparuese efikasë të cilat t’u ofrojnë asistencë viktimave. Limitet kohore për kërkesat e kompensimit në gjykata duhet të marrin parasysh pengesat ekzistuese dhe të fillojnë nga data kur viktimat u njoh për së pari me sterilizimin e saj.

Në mënyrë që të parandalohet ripërsëritja e sterilizimeve me forcë dhe detyruese, është e rëndësishme gjithashtu që të adoptohen ndryshime legjislative të cilat vendosin qartë kriteret për dhënien e pëlqimit nga pacienti ndaj një procedure sterilizimi, vendim i cili duhet të jetë i lirë, paraprak dhe i mirëinformuar, duke përfshirë një periudhë reflektimi të nevojshme për të. Ndëshkimet gjyqësore dhe administrative ndaj personave përgjegjës për sterilizimin e grave pa pëlqimin e tyre të plotë dhe të painformuar duhet të lihen gjithashtu në fuqi.

Heqja e kujdestarisë së fëmijëve romë nga prindërit e tyre biologjikë

Fëmijët romë janë shpesh të mbipërfaqësuar në qendrat e kujdesit jashtë-familjare, duke përfshirë qendrat institucionale dhe ato të edukimit. Fëmijët romë u hiqen familjeve të tyre në disa raste vetëm me justifikimin se shtëpitë e tyre nuk janë të përshtatshme dhe të stabilizuara, ose për arsye se kushtet ekonomike dhe sociale nuk janë të kënaqshme. Në disa shtete, institucionalizimi i lartë i fëmijëve romë rezulton nga trashëgimia e politikave të periudhës komuniste, gjatë të cilave shteti promovojë si të qënurit superior ndaj prindërve për edukimin e fëmijëve, sidomos në ato raste ku fëmijët vinin nga origjina familjare të dobëta e të privuara, ose kur fëmijët vetë kishin ndonjë formë çrregullimi.

Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Strasbourgut, shtetet anëtare duhet të sigurohen se asnjë fëmijë nuk duhet të vendoset në qendra institucionale vetëm duke u bazuar në kushtet e varfëra të strehimit ose në situatën ekonomike të tij ose të familjes së tij. Vendosja e një fëmije në një institucion duhet të jetë përjashtim dhe duhet të ketë si objektiv kryesor gjetjen e më të mirës për fëmijën. Gjithashtu, adoptimi dhe vendosja nën kujdesin e një familjeje pritjeje duhet të bëhet me procedura të qarta e që përputhen me standartet ndërkombëtare.

Ligji zakonor dhe martesë tradicionale mes disa grupeve romë

Disa grupime romë vazhdojnë praktikën e ligjit zakonor dhe të martesave tradicionale. Këto bashkime joformale kanë implikime në realizimin e një morie të drejtash të njeriut. Së pari, kur në to përfshihen dhe minorenë, këto praktika mund të shkelin të drejtat e fëmijëve duke përjetësuar njëkohësisht në praktikë rolin inferior të gruas. Duke siguruar përputhjen me standardet e të drejtave të njeriut, duhet të bëhet kujdes maksimal në mënyrë që të evitohen gjeneralizime dhe stigmatizime të komuniteteve të tëra. Në fokus duhet të jenë aktivitetet e edukimit dhe të rritjes së ndërgjegjësimit. Së dyti, adultët që kanë hyrë në një martesë jo zyrtare bazuar në ligjet zakonore, mund t’u refuzohet ose t’u jepen më pak të drejta ekonomike dhe sociale sesa çiftet e bashkuar zyrtarisht. Ashtu siç është nënvizuar nga Gjykata e Strasburgut, disa rregullime janë të

nevojshme në mënyrë që të evitohet që grupet minoritare, duke përfshirë romët, të bien viktima të një diskriminimi indirekt në përfitimin e këtyre të drejtave.

Romët dhe trafiku i qënieve njerëzore

Raportimet që kanë mbërritur tek Komisioneri tregojnë se trafiku i qënieve njerëzore në Europë prek romët disproporcionalisht. Romët raportohet të jenë trafikuar për qëllime të ndryshme, duke përfshirë shfrytëzimin seksual, për shfrytëzim si punëtorë e si shërbëtorë, për adoptim ilegal dhe për lypje. Gratë dhe fëmijët romë janë shpesh herë të mbi-përfaqësuar si viktima të çdo lloji trafiku. Vulnerabiliteti i romëve duhet të merret parasysh në politikat kombëtare që prekin trafikun e qënieve njerëzore pa asnjë lloj stigmatizimi ndaj tyre. Masat mbrojtëse duhet të përfshijnë trajnimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe fushata ndërgjegjësimiti që synojnë komunitetet rome, në veçanti komunitetet e ndara ose të përjashtuara nga shoqëria.

Përfitimi i të drejtave ekonomike dhe sociale nga romët dhe shtegtarët

E drejta e edukimit

Disa mijëra romë anëmbanë Europës nuk janë pjesë e sistemit arsimor, nuk janë fare të shkolluar ose kanë lënë shkollën me një edukim shumë të ulët. Në disa vende, fakti që romët dhe shtegtarët nuk kanë dokumente identifikimi ka një impakt negativ në rregjistrimin në shkolla. Mungesa e transportit publik ose e fondeve për transport, ashtu si dhe ngacmimet raciste dhe mungesa e materialeve shkollore, përbëjnë pengesa shtesë në rrugëtimin e nxënësve romë që dëshirojnë të shkollohen. Në disa shtete, fëmijët romë janë të mbi-përfaqësuar në sistemet alternative si “shkollimi në shtëpi”. Shumë fëmijë me probleme të zhvillimit, probleme mendore ose fizike, nuk arrijnë të paraqiten fare në shkollë në shumë vende europiane. Fëmijët romë vuajnë gjithashtu mungesën e strukturave para-shkollore.

Politika dhe praktika që i ndajnë fëmijët romë nga fëmijët e tjerë në sistemin arsimor janë hasur në disa shtete anëtarë të Këshillit të Europës. Mjediset edukuese të tyre janë shpesh të izoluar në rastet kur romët jetojnë në komunitete të ndara – qofshin ato grupime në lagje të varfëra ose në geto urbane. Fakti që prindërit jo-romë i tërheqin fëmijët e tyre nga shkollat e frekuentuara nga romët prodhon de fakto izolimin e shkollave të tëra. Dhe në shkollat e zakonshme, nxënësit romë janë shpesh të veçuar nga shumica e klasës, duke u vendosur në hapësira të veçanta të klasës, ose në klasa krejtësisht të ndara. Klasa zëvendësimi, klasa të izoluar si dhe veçimi në klasa janë hasur në disa vende europiane.

Fëmijët romë janë gjithashtu të orientuar në mënyrë disproporcionale drejt shkollave speciale, në veçanti në shkollat për fëmijët me probleme mendore. Në Republikën Çeke, veçimi vazhdon pavarësisht vendimit të Gjykatës së Strazburgut të 2007-ës në gjykimin *D.H. dhe të tjerë kundër Republikës Çeke*, dhe futjes në fuqi të Aktit për Shkolla të reja në 2004 i cili ristrukturoi ofertën për edukimin me nevoja speciale. Mendohet se 30% e fëmijëve romë vazhdojnë të jenë të edukuar në shkolla të parashikuara për fëmijët me probleme mendore, krahasuar me 2% për fëmijët jo-romë.

Këto praktika janë hasur në një grup vendesh të tjera. Komisioneri ka mbajtur qëndrim kundër çdo lloji forme veçimi në edukim dhe ka bërë thirrje për angazhime të qarta dhe zhvillime të matshme në drejtim të mosizolimit dhe të një arsimimi gjithëpërfshirës. Mosizolimi duhet të kombinohet me masa mbështetjeje të nevojshme për fëmijët në mënyrë që ata të integrohen me klasat e zakonshme duke ju dhënë shansi të dalin me sukses dhe të dallohen në mësim.

Në disa komunitete rome, prindërit e vajzave mund të presin nga bijat e tyre që të braktisin shkollimin para kohe në mënyrë që të martohen dhe të krijojnë familjet e tyre. Ka raste ku martesat mes fëmijëve i detyron vajzat të mos shkojnë më në shkollë, duke i privuar ato nga e

drejta e shkollimit si dhe nga mundësia e punësimit në të ardhmen. Masat pozitive mbi rritjen e ndërgjegjësimit duket se kanë sjellë progres në përmirësimin e shkollimit të vajzave rome.

Dhe pse disa shtete në Europë kanë filluar të zhvillojnë dhe realizojnë politika mbi arsimimin për shtegtarët që në 1960-ën, ngelet shumë për të bërë. Faktikisht, vitet e fundit, në disa vende jemi përballur me një lloj erozioni të masave që ekzistonin më parë për edukimin e shtegtarëve. Është e rëndësishme që një vëmendje e veçante t'u kushtohet në këto vende rregjistrimit në shkolla të fëmijëve të shtegtarëve në veçanti si dhe atyre fëmijëve, familjet e të cilëve bëjnë një jetë shtegtare.

Aty ku arsimi ofron mësim mbi gjuhën, historinë apo kulturën rome, shpesh herë ato u drejtohen kryesisht ose vetëm fëmijëve romë, duke privuar jo-romët nga e drejta për të mësuar mbi kontributet e romëve në shoqërinë e tyre dhe në atë europiane. Në tërësi, zhvillimi i kurrikulës shkollore në këtë fushë është në fazën fillestare. Përmirësimi i cilësisë së edukimit të marrë nga fëmijët romë dhe fëmijët e shtegtarëve nënkupton detyrimisht dhe përfshirjen e kulturës dhe historisë rome dhe të shtegtarëve në kurrikulën bazë.

Mundësia për një strehim të përshtatshëm

Diskriminimi lidhur me strehimin është hasur në disa shtete anëtare, shpesh duke marrë formën e refuzimit të aksesit në tregun e strehimit publik dhe privat barabar me njerëz të tjerë, ose për më tepër duke u refuzuar romëve shitjen e shtëpive si blerës.

Disa autoritete lokale kanë ndjekur një politikë të izolimit urbanistik. Kjo është përforcuar në disa raste nga ndërtimi i mureve ndarës afër me lagjet rome. Masa të tilla shkatërruese duhet të ndalohen.

Shumë romë vazhdojnë të jetojnë në kushte të një standarti të ulët në shumë vende europiane, pa ngrohje, ujë ose kanalizime. Një shqetësim i transmetuar me gojë nga ndërkombëtarët prek situatën e romëve në disa lokalitete në Mitrovicë dhe rreth e rrotull saj në Kosovë¹ ku romët, gjatë një periudhe mbi 10 vjeçare, janë strehuar në mjedise me kushte tejet toksike.

Romët që jetojnë në vendbanime informale ose në toka që nuk u përkasin, ashtu si dhe romët që jetojnë në shtëpi ligjrisht të njohura, kanë mungesë sigurie në zotërimin e tyre anembanë Europës. Mungesa e një njohjeje të përshtatshme të shfrytëzimit të tokave çon drejt rrezikut të dëbimeve me forcë. Në disa shtete, numri i dëbimeve me forcë është rritur gjatë viteve të fundit, shpesh herë duke synuar të njëjtat familje imigrante rome, duke përfshirë fëmijët, në raste të njëpasnjëshme brenda një kohe shumë të shkurtër. Përsëritja e dëbimeve me forcë në disa vende të Europës përendimore, duke përfshirë dhe shkatërrimin e pronës, është përshkruar si një strategji për të nxitur romët të kthehen në vëndet e tyre të origjinës, me konkretisht në Rumanë e Bullgari. Në disa raste janë shkatërruar lagje të tëra të vjetra shekullore. Dëbimi me forcë duhet të organizohet vetëm sipas procedurave dhe garancive ndërkombëtare zhvilluar, ndër të tjera, nga komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Komenti i Përgjithshëm Nr.7).

Komisioneri ka observuar se në disa vende është krijuar një rreth vicioz sipas të cilit autoritetet refuzojnë të zhvillojnë infrastrukturën pasi komuniteteve rome u mungon veshja dhe qëndrimi dinjitoz ose formal, duke refuzuar njëkohësisht të pranojnë që kjo gjë vjen nga infrastruktura e një standarti të ulët. Komisioneri u ka kërkuar autoriteteve të gjejnë rrugë për të zgjidhur këto konflikte konform me standartet ndërkombëtare dhe europiane të të drejtave të njeriut.

Shtegtarët janë gjithashtu disproporcionalisht të prekur nga format e diskriminimit, të cilat prekin dhënien e lejeve të ndërtimit në rast se ata, ose të tjerë, blejnë tokë private me qëllim që të parkojnë karvanet e tyre, si dhe forma diskriminimi të tjera përsa i përket aksesit në vend

1. Në përbërje të këtij teksti, çdo referencë ndaj Kosovës, qoftë ndaj territorit, institucioneve ose popullatës do të nënkuptohet si në akord të plotë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim mbi statusin e Kosovës.

kampime, hotele dhe/ose forma të tjera strehimi të përkohshëm. Komisioneri e ka bërë pozicionin e tij mjaft të qartë duke kujtuar se në shtetet ku ekziston një popullësi migrante shtegtare, duhet të ketë një detyrim statutor mbi autoritetet lokale për vënien në dizpozicion të hapësirave me standarteve dinjitoze për vend-kampime karvanësh për një periudhë afatgjatë dhe afatshkurtër.

Komisioneri ka theksuar se e drejta e romëve për një strehim të përshtatshëm në përputhje me standartet ndërkombëtare duhet garantuar. Të gjitha infrastrukturat publike, duke përfshirë ujin, elektricitetin, mbledhjen e plehrave si dhe mirëmbajtjen e rrugëve hyrëse duhet t'u ofrohen kampeve të romëve. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës në përmirësimin e kushteve të strehimit për romët dhe shtegtarët në Europë, bën thirrje për një rishikim të legjislacionit, të politikave dhe të praktikave të strehimit me qëllim heqjen e çdo dispozite ose praktike administrative, e cila rezulton në diskriminimin direkt ose indirekt të romëve.

E drejta për punësim

Sfidat në integrimin e romëve në tregun e punës janë të shumta dhe rezultojnë në një përjashtim terësor të romëve dhe shtegtarëve nga punët dinjitoze në Europë. Diskriminimi endemik i kombinuar me nën-edukimin e tyre, duket sikur anulon efektin e politikave të kohëve të fundit mbi punësimin e romëve dhe shtegtarëve. Pavarësisht efekteve pozitive në disa shtete, niveli i papunësisë ndër romët dhe shtegtarët ngelet njësoj kudo në Europë dhe në mënyrë të konsiderueshme më i lartë sesa ndër popullatën jo-rome.

Në një numër shtetesh, romëve dhe shtegtarëve u refuzohet punësimi në mënyrë diskriminuese duke u bazuar në etnicitetin e tyre si dhe në perceptimin e përkatësisë së tyre në komunitetin ose grupet rome dhe të shtegtarëve. Tendenca në Europë tregon gjithashtu se romët e punësuar kanë më shumë gjasa të përballen me diskriminimin në vendet e tyre të punës. Diskriminimi prek njëkohësisht romët e shkolluar të cilët pengohen të përparojnë më lart. Anëmbanë Europës, ndërsa perceptimet për diskriminimin janë të përhapura, të dhënat statistikore mungojnë, kjo pjesërisht pasi diskriminimi në tregun e punës është shpesh herë i maskuar. Diskriminimi racial ose etnik në tregun e punës është në kundërshtim me Konventën Sociale Europiane, si dhe me Direktivën e Bashkimit Europian mbi Barazinë Racore. Masat ndaj papunësisë së romëve dhe shtegtarëve duhet të përmbajnë asistencën ndaj viktimave të diskriminimit në mënyrë që të kenë të drejtë të kërkojnë të drejtat e tyre.

Janë shfaqur gjithashtu probleme diskriminimi gjinor. Punëmarrësit europianë kanë diskriminuar gratë rome për arsye të gjinisë dhe etnicitetit të tyre njëherazi. Një kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet grave rome, të cilat vuajnë nga një diskriminim i dyfishtë, një kujdes që duhet të përpiqet gjithashtu të përmirësojë statusin e tyre socio-ekonomik dhe të sigurojë aksesin në sistemin edukativ dhe shëndetësor si parakusht për punësimin e tyre.

Komisioneri ka bërë thirrje për masa specifike, duke përfshirë dhënien e fondeve, për zhvillimin e programeve që nxisin punësimin dhe iniciativat private në komunitetet rome, si për shëmbull, programe të trajnimit specifike.

E drejta për standartet më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mendor

Anëmbanë Europës, jetëgjatësia mesatare e romëve dhe shtegtarëve është më e shkurtër se ajo e popullatës jo-rome dhe jo-shtegtare. Normat e vdekshmërisë foshnjore rome dhe të shtegtarëve janë më të larta. Faktorët që pengojnë aksesin e romëve dhe shtegtarëve në shërbimet e shëndetit përfshijnë mungesën e fondeve për të paguar për sigurimet ose trajtimet, mungesën e mjeteve të identifikimit, si dhe mungesën e mjeteve të transportit nga zonat e largëta drejt qendrave shëndetësore.

Eshtë raportuar gjithashtu se furnizuesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor diskriminojnë romët, përfshirë këtu dhe në dhënien e shërbimeve të urgjencës. Disa spitale veçojnë pacientët romë nga pacientët jo-romë, sidomos në pavijonet e materniteve. Shumë pak romë ose individë shtegtarë punojnë në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Në disa shtete, romët janë përjashtuar nga skemat e kujdesit shëndetësor, pasi nuk janë në gjëndje të paguajnë për kontributet e sigurimeve shëndetësore ose nuk janë zyrtarisht të punësuar ose të regjistruar në agjencitë e punësimit.

Dispozitat ekzistuese mbi të drejtën për standartet më të larta të arritshme të shëndetit fizik dhe mendor duhet të aplikohen mbi romët dhe shtegtarët, ashtu siç është rekomanduar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në 2006-ën. Një shërbim shëndetësor gjeografikisht i arritshëm dhe ekonomikisht i përballueshëm duhet t'u ofrohet pa diskriminim romëve dhe shtegtarëve. Shtetet anëtare duhet të bëjnë përpjekje në fushën e shëndetësisë parandaluese dhe në fushata ndërgjegjësuese për romët dhe shtegtarët, në veçanti në fushën e shëndetësisë seksuale dhe të riprodhimit të grave romë.

E drejta për sigurimet sociale

Raportohet se faktorët që ndikojnë negativisht në aftësinë e romëve dhe shtegtarëve në marrjen e shërbimeve sociale përfshijnë dhe diskriminimin ndaj romëve dhe shtegtarëve nga nënpunësit e shërbimeve sociale. Komisioneri ka marrë raporte mbi refuzimin e plotë të shërbimit ose dhënien e reduktuar të shumave të asistencës. Ka patur gjithashtu raportime mbi aplikimin diskriminues të programeve të ndihmës sociale (si për shëmbull ndihma sociale e mjeteve të testuara); përdorimi i rregullores dhe/ose politikave që kanë një efekt përjashtues duke i bërë romët dhe shtegtarët të mos kenë mundësi për të përfituar nga shërbimet sociale; izolimi territorial i romëve dhe shtegtarëve duke bërë që shërbimet të arrihen me vështirësi; barrierat komunikuese mes zyrave të shërbimeve sociale dhe individëve romë ose shtegtarë; mungesa e informacionit në komunitetet romë dhe ato të shtegtarëve; si dhe barrierat tjera. Romët pa nënshtetësi kanë marrë gjithashtu mbi baza arbitrare një trajtim të tjetërsuar nga shërbimi standart. Disa autoritete kanë deklaruar që nuk do t'u japin shërbime sociale "romëve shëtitës". Eshtë e nevojshme pra të ndërmerren masa për të ndryshuar këto qëndrime diskriminuese të punonjësve të shërbimeve sociale, duke përfshirë organizimin e trajnimeve mbi nevojat për shërbime sociale të romëve dhe të shtegtarëve. Informacione mbi shërbimet sociale ekzistuese duhet t'u vihen në dispozicion romëve dhe shtegtarëve, duke përfshirë dhe romët imigrues. Shtetet anëtare duhet të evitojnë diskriminimin indirekt duke rishqyrtuar legjislacionin dhe politikën që kanë të bëjnë me shërbimet sociale.

E drejta për shërbimet, mallrat dhe hapësirat publike

Romët dhe shtegtarët anëmbanë Europës diskriminohen në përdorimin e mallrave dhe shërbimeve të vëna në dispozicion të publikut. Diskriminimi raportohet në përdorimin e hoteleve, diskotekave, restoranteve, bareve, pishinave publike si dhe në struktura të tjera argëtuese, ashtu si dhe në përdorimin e shërbimeve jetike për aktivitetin e firmave të vogla si kreditë bankare. Dhe pse programet qeveritare që përballen me këto diskriminime janë aktualisht të pakta, shëmbujt nga disa shtete anëtarë të Këshillit të Europës tregojnë se aksioni në këtë fushë mund të jetë i rëndësishëm për të identifikuar dhe t'u përballur me format dhe praktikën e diskriminimit racial ndaj romëve. Duhet krijuar organizma efikase dhe të pavarur mbi barazinë, të cilët në misionet e tyre të kenë realizimin e studimeve dhe kërkimeve mbi diskriminimin në përdorimin e mallrave dhe shërbimeve, duke u dhënë në të njëjtën kohë orientime dhe mbështetje ofruesëve të këtyre shërbimeve mbi praktikën e mira, se si mund të promovojnë barazinë, të përshtaten ndaj diversitetit dhe të luftojnë diskriminimin ndaj kësaj popullate.

Mungesa e shtetësisë dhe mangësitë në dokumentacionin personal të romëve

Përjashtimi social i romëve dhe shtegtarëve mund të përkeqësohet si pasojë e mospasjes nga ana e tyre një ekzistence administrative formale. Ashtu si theksoi dhe Komisioneri në Komentin mbi të Drejtat e Njeriut, “Romët pa shtetësi: pa dokumenta – pa të drejta”: “... dhjetëra mijëra romë jetojnë në Europë pa një shtetësi. Në mungesë të një çertifikatë lindjeje, dokumenti identiteti, pashaporte dhe dokumenti tjetër, atyre u refuzohen të drejta themeltare si edukimi, shëndetësia, asistenca sociale dhe e drejta e votës.”

Shumë faktorë kontribuojnë në vështirësimin e marrjes së dokumentave dhe të shtetësisë nga ana e romëve, duke përfshirë konfliktet e armatosura, imigracioni i detyruar, varfëria ekstreme dhe marginalizimi dhe mbi të gjitha, mungesa e një interesi të vertetë nga ana e autoriteteve për t'u marrë me këto çështje dhe për t'i zgjidhur ato. Këto vështirësi amplifikohen kur romët e gjejnë veten në situata shpërnguljeje të detyruar.

Mes pengesave të reja që prekin disproporcionalisht romët mund të përmendim, disa nga pasojat e krijimit të entiteteve shtetërore të reja, si dhe ligjet kufizuese të shtetësisë. Si rezultat, shumë romë në Europë janë pa shtetësi : ata nuk konsiderohen shtetas të asnjë shteti dhe u refuzohen shpesh të drejta bazike si ato sociale dhe liria e lëvizjes. Ky problem ekziston në shumë vende në Europë, por është veçanërisht më delikat në Ballkanin Prendimor. Mungesa e një ekzistence administrative formale, qoftë në formën e mungesës së shtetësisë ose në mungesën e dokumentave të identifikimit personal, ka një impakt të jashtëzakonshëm në mundësitë e çdo njëri të përfitojë nga të drejtat dhe liritë e tij thelbësore. Gjatë viteve të fundit, Komisioneri i Lartë i OKB-se për Refugjatët (UNHCR) ka organizuar programe me qëllim që t'i ndihmojë romët në Ballkanin prendimor të marrin dokumentat personale. Bashkimi Europian ka filluar gjithashtu programe të ngjashëm në këtë drejtim. Pavarësisht kësaj, pa angazhimin e fuqishëm në nivelin e shtetit për të përmirësuar kushtet në mënyrë që personat e lënë mënjane të kenë mundësinë të pajisen me dokumenta, për shëmbull nëpërmjet “amnistive” për personat pa çertifikatë lindjeje ose masave të ngjashme, ka pak gjasa që këto projekte pilote (ose projekte të ngjashëm ad hoc) të kenë ndonjë impakt të madh.

Shfrytëzimi i të drejtës së lëvizjes së lirë dhe i mbrojtjes ndërkombëtare brenda dhe jashtë territorit shtetëror nga ana e romëve dhe shtegtarëve

Shumë pak shtete europiane janë angazhuar që shtegtarët të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre të lëvizjes së lirë, pavarësisht jurisprudencës së Gjykatës së Strazburgut në këtë pikë. Në fakt, politikat ekzistuese në shumicën e shteteve me disa përjashtime, shërbejnë për t'i trembur shtegtarët në organizimin e shpeshtë të rrugëtimit migrator. Në praktikë, masat mbi zonat si dhe rregullat dhe rregulloret e tjera në këtë drejtim përdoren për të dekurajuar shtegtarët ose romët udhëtues në organizimin e vajtje-ardhjeve të shpeshta. Kornizat rregullatore mund të shtojnë barra të tjera ose të krijojnë limitime të veçanta ndaj të drejtave të shtegtarëve. Në Francë për shëmbull, individët shtegtarë me shtetësi franceze janë objekt i një legjislacioni të veçantë që nuk u aplikohet shtetasve të tjerë francezë. Në vende të tjera, refuzimi i lejeve të planifikimit për strehimin e shtegtarëve limiton mundësitë për këta të fundit të përdorin tokat e tyre për të praktikuar traditat e tyre. Shtetet me një minoritet shtegtar ose gjysëm të vendosur duhet t'u përshtaten Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (2005) mbi përmirësimin e kushteve të strehimit të romëve dhe shtegtarëve në Europë në mënyrë që të bëhet e mundur për të gjithë romët dhe komunitetet shtegtare që të jetojnë sipas zgjedhjes së tyre.

Dhe në rastet kur janë nën rrezikun e shkeljes serioze të të drejtave të njeriut, romët përballen me diskriminimin gjatë vënies në lëvizje të mekanizmave mbrojtës krahasuar dhe në një bazë të njëjtë

me pjesën tjetër të popullsisë, përfshirë këtu dhe ndjekjen e procedurave të azilit. Në disa shtete, azil-kërkuesve romë, u është dhënë një lloj mbrojtjeje e përkohshme, e cila nuk u jepte statusin e residencës madje as një shfaqje progresive të të drejtave. Përsëritja e dispozitës së një statusi “të toleruar” tejet të shkurtër në kohë ka penguar me dhjetëra mijëra romë që vinin nga vende të tjera të integrohen në shoqëritë e vendeve pritës. E drejta e azilit është e njohur nga Konventa e OKB-së mbi Statutin e Refugjatit (1951) për të gjithë refugjatët pa diskriminim. Azil-kërkuesit romë dhe njërëzit e zhvendosur (IDPs) duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si azil-kërkuesit dhe njërëzit e zhvendosur jo-romë.

Shumë vende europiane kanë ndjekur praktika dëbimi të romëve nga territoret e tyre, duke përfshirë këtu drejt Kosovës, pavarësisht faktit se Kosova nuk është aktualisht në gjëndje të sigurojë kushtet për një reintegrim të qëndrueshëm të të kthyerve, duke u bazuar ndër të tjera burime, në vlerësimin e UNHCR-së të nëntorit 2009. Komisioneri ka kundërshtuar vazhdimisht kthimin e detyruar ose jo të vullnetshëm të romëve, ashkalive ose egjiptianëve në Kosovë. Dokumenti i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, *20 Udhëzime mbi Kthimin e Detyruar* parashikon standarte për procedura mbrojtjeje të cilat shtetet anëtare duhet t'i respektojnë kur ndërmarrin një kthim të detyruar. Udhëzimet theksojnë se dëbimi kolektiv i të huajve është i ndaluar.

Liria e lëvizjes së mallrave, të shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve janë objektiva themeluese të Bashkimit Europian. Pavarësisht kësaj, romët janë trajtuar në mënyrë të përsëritur ndryshe nga jo-romët në ushtrimin e kësaj të drejte. Përpjekjet për të përzënë shtetas të BE-së në kundërshtim me ligjet e BE-së, ashtu si dhe masat diskriminuese me synim vështirësimin e hyrjes në territorin e vendit, duhet të ndalohen. Komisioneri ka sugjeruar se burimet e përdorura nga vendet anëtare të BE-së për të riatdhesuar romët që janë shtetas të BE-së do të ishin përdorur më mirë për të thjeshtëzuar integrimin e tyre social.

Pjesëmarrja e romëve dhe shtegtarëve në jetën publike si dhe në procesin e vendim-marrjes

Shumë romë dhe individë shtegtarë janë praktikisht në pamundësi për të votuar, në shumë raste për arsye të pengesave administrative ose mungesës së dokumentave personale ose në mungesë të një residence të përhershme. Qeveria duhet shfuqizoje çdo ligj dhe normë që diskriminon minoritetet romë përsa i përket përfaqësimit politik. Më shumë përpjekje në terren janë të nevojshme për të siguruar rregjistrimin e votuesve. Duhet theksuar përsëri se është me rëndësi që të arrihet të vendoset kontakti me gratë.

Përveç disa përjashtimeve pozitive, romët mungojnë gjithashtu masivisht në organizmat e zgjedhur në nivelin lokal, rajonal, kombëtar si dhe mbi-kombëtar. Pjesëmarrja e romëve në parlamentet e Europës është tejet e limituar. Vetëm në disa shtete në Europën qendrore dhe Europën Jug-lindore romët gjenden në të gjitha shkallët e parlamentit. Nuk ka aktualisht asnjë rom në parlamentet e Europës perëndimore. Në disa shtete, numri i përfaqësuesve vendorë – duke përfshirë kryetarët e bashkive dhe këshilltarët vendorë – duket sikur është rritur gjatë dekadës të fundit. Gjithsesi, dhe në këto vende, proporcioni i romëve të zgjedhur në një post publik në nivelin lokal është tejet i ulët duke e krahasuar me përfaqësimin e tyre në popullsinë e marrë së bashku.

Komisioneri ka nënvizuar se praktika e vendeve të rezevuara sipas kuotave kanë patur rezultate pozitive, ashtu si dhe përqëndrimi në pjesëmarrjen e romëve në nivelin lokal. Është e rëndësishme që përfaqësuesit e zgjedhur të minoriteteve të marrin pjesë në proceset e vendim-marrjes, duke përfshirë fushat që nuk janë të lidhura në mënyrë strikte me minoritetet kombëtare, dhe që roli i tyre të mos jetë i kufizuar në një status të rëndomtë observuesi.

Disa vende kanë vënë në lëvizje mekanizma që inkurajojnë komunikimin e barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të hapur me romët. Në të gjitha nivelet, duhen inkurajuar konsultimet e organizuara, në përputhje me parimet e përfaqësimit dhe transparencës të detajuara në Komentin e 2008-ës të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër të Minoriteteve Kombëtare, mbi pjesëmarrjen reale të personave që i përkasin minoriteteve kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike si dhe në çështjet publike. Përfaqësimi i romëve dhe shtegtarëve në jetën publike do të përmirësohej konsiderueshëm sikur romët dhe shtegtarët të ishin përfaqësuar në mënyrë të dukshme në mes të radhëve të funksionarëve publikë, duke përfshirë këtu mësuesit dhe policët në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar. Por sot, megjithatë, integrimi në punësimin publik ngelet i ulët, dhe në shumicën e tij pak i dallueshëm. Zhvillimi i programeve të praktikave speciale për romët në shërbimin publik duhet inkurajuar, në mënyrë që të rritet përfaqësimi rom brenda shtetit, brenda administratës lokale.

Komisioneri shpreson se shtetet anëtare do të zgjedhin t'i japin një përparësi të lartë dhe të sinqertë integritit të romëve dhe shtegtarëve. Përjashtimi i vazhduar i më shumë se 10 milion qenieve njerëzore mund të sjellë vetëm rritjen e tensioneve ndër-etnike në Europë. Shtetet anëtare, duhet të marrin masa konkrete për të përballur frymën anti-cigane dhe t'i japin fund diskriminimit dhe marginalizimit. Nevojiten urgjentisht përpjekje për të siguruar të drejtat e njeriut të romëve dhe të shtegtarëve.

Mbyllje

Vitet 2010 dhe 2011 kanë qënë vite të avancimeve të mëdha në zhvillimin e angazhimeve konkrete të institucioneve europiane për të përballur përjashtimin e romëve. “Deklarata e Strazburgut” e Këshillit të Europës mbi romët jep nxitjen politike për të marrë masa konkrete në këtë drejtim. Kuadri i BE-së mbi Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve deri më 2020 përbën gjithashtu një hap të kërkuar gjatë nga aktivistët romë anembanë Europës.

Në anën tjetër, ka patur tendenca shqetësuese. Institucionet europiane iu përgjigjën me kujdes politikave qartësisht destruktive të të drejtave themelore të romëve në Itali dhe në Francë. Në disa momente kyçe, shtetet anëtare kanë mbytur thirrjet në nivelin europian për t’u përballur me boshllëkun e përjashtimit të romëve dhe shtegtarëve duke shpërfillur haptazi shprehjen e këtyre shqetësimeve. Ky fakt, ka minuar deri në një farë mase, përpjekjet për të theksuar rëndësinë e integritimit të romëve dhe shtegtarëve. Romët dhe shtegtarët anembanë Europës i ndjekin këto zhvillime nga afër dhe janë tejet të ndërgjegjshëm se kur vjen momenti kritik, forca fiton faktikisht mbi shqetësimin ndërkombëtar. Skepticizmi i thellë mbi faktin nëse ekziston qoftë dhe një mundësi e vetme për një ndryshim pozitiv për romët dhe shtegtarët – një sentiment tanimë i përhapur mes romëve anembanë kontinentit – përforcohet vazhdimisht kur institucionet ndërkombëtare dështojnë të arrijnë një impakt real në abuzimet e kryera nga shtetet apo dhe të tjerë.

Në të njëjtën kohë, zëra të rinj nga ekstremi i djathtë po marrin më shumë forcë, dhe ndjesia kundër çdo “diskriminimi pozitiv” për romët dhe shtegtarët duket se po rritet. Në shumë vënde, pikëpamje të tilla janë një mbulesë e cekët për ndjesinë se romët dhe shtegtarët nuk mund të pranohen kurrë si qytetarë të plotë dhe të barabartë të Europës dhe do të tolerohen vetëm nëse ata do të qëndrojnë si një popullatë e zbutur – mundësisht e padukshme – të huajsh, ose nëse ata heqin dorë nga çdo lloj lidhjeje me komunitetin rom dhe atë të shtegtarëve duke u përzier ose “asimiluar” në një “shumicë” – përgjithësisht imagjinare.

Sot, të rinjtë romë ndjekin universitetet më shumë se kurdoherë. Në disa vënde, profesionistët romë janë në organikën e ministrive ose policisë apo punojnë në administratën lokale dhe rajonale. Romët dhe shtegtarët janë gjithashtu kontribues aktivë të zhvillimit të sektorit privat në disa zona. Këto janë përparime të rëndësishme krahasur vetëm me një dekadë më parë. Ky progres është një testament për atë ç’ka është e mundshme kur komunitetet, politikë-bërësit, familjet dhe individët bashkohen së bashku për t’u përballur dhe me format më të thella të përjashtimit. Pavarsisht kësaj, pa një angazhim të vazhdueshëm dhe të rifreskuar, këto avancime ngelen të brishta – dhe të kthyeshme. Progresi i bërë deri më tani zbehet në krahasim me shtrirjen dhe thellësinë e përjashtimit që mbizotëron aktualisht në disa sektorë të komuniteteve romë dhe të shtegtarëve.

Difektet në katër “temat prioritare” të identifikuar nga Kuadri i BE-së mbi Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve deri më 2020 – edukimi, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe punësimi – duhet të trajtohen pa vonesë. Trajnimi i ndërmjetësuesve romë në fushën e edukimit, shëndetësisë dhe punësimit filluar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Europës për çështjet e romëve, duket të jetë një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se legjislacioni dhe praktikat e tyre kombëtare janë në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Komitetit Europian të Çështjeve Sociale në

këto katër fusha. Është e një rëndësie të veçantë që fëmijët romë të zhvendosen pa vonesë drejt mjediseve të edukimit të zakonshëm dhe t'u jepen mësimet e nevojshme dhe çdo lloj mbështetjeje tjetër me vend, që t'i lejojë t'ja dalin mbanë dhe të dallohen në arsim.

Për më tepër, ky raport tregon qartë lidhjen mes të drejtave për edukim, për kujdesin shëndetësor, strehimin dhe punësimin me të tjera të drejta dhe liri themelore të njeriut. Prioritet kyç të Kuadrit të BE-së mund dhe duhet të shihen në një kontekst më të gjërë për fusha të tjera, si policia dhe gjyqësori. Në mënyrë që të jenë efikase, Strategjitë Kombëtare të Integritimit të Romëve duhet të bazohen mbi të drejtat e njeriut, dhe të mbulojnë çdo fushë tematike me rëndësi për integrimin e romëve. Situata e të drejtave të njeriut të romëve dhe të shtegtarëve duhet të trajtohet si një e tërë dhe duke trajtuar në të njëjtën kohë sektorë të ndryshëm. Aty ku është e mundur, objektivat duhet të vendosen për të shkuar më tej se katër qëllimet e BE-së për integrimin e romëve në lidhje me arsimin, punësimin, shëndetësinë dhe strehimin.

Vazhdimi i fenomenit të diskriminimit racial kërkon një vëmendje të menjëherëshme. Miratimi dhe implementimi i një legjislacioni të gjerë anti-diskriminues është një hap i nevojshëm. Shtetet anëtare që nuk e kanë bërë akoma këtë gjë duhet të miratojnë njëkohësisht Protokollin nr. 12 të Konventës të të Drejtave të Njeriut, i cili parashikon një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit. Strukturat kombëtare që promovojnë barazinë si dhe ato që ndjekin ankesat e një niveli të ulët kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në realizimin e kompensimeve efektive dhe të prekshme për viktimat e diskriminuara romë dhe shtegtare. Veç heqjes së barrierave në mënyrën sesi zbatohen të drejtat, shtetet anëtare duhet të marrin masa pro-aktive në mënyrë që romëve dhe shtegtarëve t'u jepet një shans real në mbikalimin e një historie të gjatë përjashtimi.

Ciklet e dëbimeve me forcë të romëve nga shtëpitë, lokalitetet dhe vëndet e tyre, duhet të ndalohen nëse duhet të arrijmë në një integrim social të vërtetë të romëve. Për të vepruar sipas kësaj domosdoshmërie, shtetet europiane duhet të bashkëpunojnë pozitivisht me organizatat romë dhe shoqërinë civile në mënyrë që të gjenden zgjidhje të përshtatshme. Ato duhet të pranojnë njëkohësisht mënyrën e jetesës së romëve shëtitës dhe gjysëm-shëtitës, sipas zgjedhjeve të tyre personale.

Problemi i mungesës së shtetësisë si dhe mungesës së dokumentave personale për mijëra romë në Europë duhet të ngrihet me vendosmëri, pasi këtyre njerëzve u mohohen shpesh të drejta bazike si edukimi, kujdesi shëndetësor, asistenca sociale si dhe e drejta për të votuar.

Një kujdes i veçantë duhet t'u jepet atyre grave që janë viktime të sterilizimit me forcë dhe të detyrueshëm si dhe viktimave të trafikut të qënieve njerëzore.

Strategjitë që synojnë integrimin e romëve dhe shtegtarëve duhet të implementohen me pjesëmarrjen e vetë komuniteteve në zhvillimin, realizimin dhe vlerësimin e këtyre politikave. Nuk do të ketë asnjë përmirësim në këto fusha pa pjesëmarrjen e romëve dhe komuniteteve shtegtare në proceset e vendim-marrjes.

Mbi të gjitha, autoritetet në Europë duhet të merren, për një herë e gjithmonë, me paragjykimet dhe stereotipet kryesore – si fryma anti-cigane – që nxisin diskriminim dhe dhunën kundra romëve dhe njerëzve të udhëtimit në europë. Është koha që përshtatshme negativ i romëve në media dhe sferën politike të përfundojë. Komisioneri beson se një aksion i përbashkët në hetimin dhe ndëshkimin e formave individuale dhe kolektive të dhunës kundra romëve duhet të ndërmerren në të gjitha rastet e rëndësishme. Pa fshirjen e frymës anti-cigane, të gjitha përpjekjet dhe programet që synojnë integrimin e romëve do të jenë të kota.

Komisioneri është i bindur që kjo është në fakt e vetmja mënyrë për të ecur përpara: qeveritë dhe administratat e Europës duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të përfshirë të gjithë segmentet e shoqërisë për të siguruar një integrim të sigurtë të romëve. Përndryshe, Europa do të jetë në

rrezik të një polarizimi etnik të mëtejshëm me zhgënjime që shkaktojnë dhunë në të gjithë krahët. Përpjekjet për të siguruar në praktikë të drejtat themelore të njeriut të romëve, mund dhe duhet të jenë e tashmja dhe e ardhmja e Europës.

Komisioneri u bën thirrje qeverive të Europës të intensifikojnë dhe thellojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që romët të gëzojnë më në fund një dinjitet të barabartë në shoqëri pa diskriminim.

